



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.shk.II.nr.282/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË -Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë Rr.Qamil Hoxha me seli në Prishtinë kundër debitorit Al-Petrol sh.p.k., me nr br.700262257, me seli në fshatin Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.759/2019 të datës 25.04.2019, jashtë seancës me datë 04.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit, Al-Petrol sh.p.k., me nr br.700262257, me seli në fshatin Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.759/2019 të datës 25.04.2019, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.759/2019 të datës 25.04.2019, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit Al-P Petrol sh.p.k., me nr br.700262257, me seli në fshatin Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit me numër P.nr.600/18 i datës 28.03.2018 nga përmbartuesi privat Flamur S. Bogaj në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, Al-Petrol sh.p.k., me nr br.700262257, me seli në fshatin Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozimin që Gjykata Apelit ankesën ta aprovoje si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta ndryshoje, ashtu që Urdhrin për përmbartim P.nr.600/18 të datës 28.03.2018 ta hudhe poshtë si të palejuar.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala kreditore, me propozimin që të refuzohet ankesa e debitorit si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Inspektorati i Punës në Kosovë ” Rr. “Qamil Hoxha” me seli në Prishtinë, me datën 28.03.2018 ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 01 Nr.60-93-1/17-A të datës 06.12.2017, gjithsej në shumën prej 5,000.00 euro, si dhe shpenzimet e përbarimit sipas tarifës Përbaruesve Privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2014 për Tarifat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përbaruesit privat.

Përbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.600/2018 të dt.28.03.2018, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 10.04.2018, ka ushtruar prapësim duke propozuar që të anulohet Urdhri për përbarim, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet përbarimore

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 17.04.2018, duke propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar në kuptim të nenit 73 par.1, 3 të LLP-së.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, në rivendosje, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.759/2019 të datës 25.04.2019, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit i ushtruar më datën 10.04.2018 me nr.1728/18 kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit me numër P.nr.600/2018 i datës 28.03.2018 nga Përbaruesi privat Flamur S.Bogaj në Prishtinë.

Gjyqtari individual i Dhomës së shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përbarimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përbarimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së

Në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarues të paraparë me dispozitën e nenit 21 përkatësisht 22 parag.1 nënparag.1.2 të LPP-së, që parasheh se organi përbarues e cakton përkatësisht e zbaton përbarimin në bazë të dokumentit përbarues. Dokument përbarues në bazë të nenit të lartë cituar të LPP-së, përkatësisht përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit përbarues siç është vendimi përbarues–vendimi i Inspektoratit të Punës, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 01Nr.60-93-1/17-A të datës 06.12.2017 i dhënë në procedurë përbarimore. Dokumenti përbarues, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, nga kjo rezulton se dokumenti përbarues i dhënë në procedurë përbarimore gjegjësisht vendimi 01 Nr.60-93-1/17-A, është i përshtatshëm për përbarim pasi që i ka të gjitha elementet e cekura më lartë dhe se gjykata me të drejtë e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se me aktvendimin e atakuar nuk është vërtetuar gjendja faktike, dhe gabimisht është aplikuar e drejta materiale. Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, gjykata në procedurë përbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përbarimit dhe në procedurën sipas prapësimin gjykata e shkallës i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore të debitorit, por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta, për faktin se në këtë çështje juridike përbarimore, përbarimi është lejuar në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.60-93-1/17A i datës 06.12.2017, i cili i plotëson kushtet për përbarim dhe është i përshtatshëm për përbarim e po ashtu paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit dhe rrjedhimisht ankesa rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike te konstatuar ne dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë, bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.shk.II.nr.282/2022 datë 04.10.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha